



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



QENDRA  
MAQEDONASE PËR  
EDUKIM  
QYTETAR



## Projekt për integrimin ndëretnik në arsim

### RAPORT MUJOR

#### i Projektit të USAID-it për integrimin ndëretnik në arsim

dhjetor 2016

#### I. AKTIVITETE TË ZBATUARA

##### Komponenti 1 – Informimi i opinionit dhe bashkësive

- **Ngjarje solemne me prerjen e shiritit.** Në mënyrë të detajuar është planifikuar dhe janë përgatitur ngjarjet solemne të prerjes së shiritit në shkollat fillore “Vëllezërit Milladinov”, f. Dedebalc, komuna e Mogillës dhe “Shën Cirili dhe Metodij”, f. Buçin, komuna e Krushevës, qëllimi i së cilave ishte të shënohet përfundimi i suksesshëm i rinovimit të shkollave. U përgatitën skenarët për këto ngjarje dhe prezantimi i aktiviteteve të cilat i zbatojnë shkollat në drejtim të zhvillimit të integritimit ndëretnik. Të njëjtat janë prezantuar në ngjarjet solemne para mysafirëve dhe bashkësitë lokale.
- **Pjesëmarrje në emisione.** Nga fundi i muajit, përfaqësuesit e ekipit të PINA-s morën pjesë në programin e mëngjesit në RTVM, me ç’rast me opinionin u ndanë aktivitetet dhe arritjet kyçe të projektit në vitin 2016, ndërsa gjithashtu u paralajmëruan edhe aktivitetet e ardhshme në kuadër të projektit.
- **Video.** U përgatit video në të cilën janë shfaqur arritjet kyçe dhe aktivitetet në drejtim të përmirësimit të integritimit ndëretnik në arsim në kuadër të projektit (<https://www.youtube.com/watch?v=neCCoErDb1g>).
- **Informim i rregullt i institucioneve, komunave dhe shkollave për aktivitetet e PINA.** Një pjesë e aktiviteteve kanë përfshirë edhe azhurnimin e rregullt të informacioneve dhe publikimin e risive dhe tregimeve për rrjedhën e aktiviteteve në faqen e facebook-ut *Integratika*, si dhe në ueb faqen e projektit [www.pmio.mk](http://www.pmio.mk). Gjithashtu, aktivitetet të cilat u zhvilluan në kuadër të shkollave (të pavarura apo në partneritet me shkollat e tjera), gjatë asaj periudhe kishin mbështetje dhe mbulim medial.

##### Komponenti 2 – Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorive të shkollave dhe arsimtarëve

- **Punëtori për reflektimin dhe qëndrueshmërinë e ngjarjeve – “Ditët e integritimit ndëretnik”.** Pas ngjarjeve përfundimtare të realizuara me sukses – Ditët për INA në gjashtë komunat, u mbajtën dy punëtori në të cilat morën pjesë përfaqësues të komunave – përgjegjës për arsim, si dhe prej shkollave të cilat janë përfshirë në këtë aktivitet. Qëllimi ishte të bëhet reflektim për realizimin e këtyre aktiviteteve. Në bazë të leksioneve të mësuara dhe nevojat e ardhshme të cilat janë identifikuar në punëtori, u përgatit dokumenti për rekomandime për qëndrueshmërinë e aktiviteteve Ditët për INA.
- **Zbatimi i pyetësorit për nxënësit të cilët morën pjesë në aktivitete në kuadër të “Ditët e integritimit ndëretnik”.** U zbatua pyetësori me nxënësit të cilët morën pjesë në aktivitetet në kuadër të “Ditëve të integritimit ndëretnik”, me qëllim të shqyrtimit të efekteve dhe përfitimeve të përvojave që nxënësit të bashkësive të ndryshme etnike i kanë pasur në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta.



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



QENDRA  
MAQEDONASE PËR  
EDUKIM  
QYTETAR



## Projekt për integrimin ndëretnik në arsim

- **Vizitë në orë të përbashkët mësimore për edukatë qytetare.** U realizua vizita e aktivitetit të përbashkët të arsimit qytetar në SHF “Bratstvo Migjeni”, komuna e Tetovës, në të cilën morën pjesë 20 nxënës të gjuhëve të ndryshme mësimore.
- **Takim me grupin punues të INA në kuadër të MASH për shqyrtimin e përmbajtjeve të hulumtimit elektronik me komunitet.** U mbajt takim me kryetarin dhe nënkryetarin e grupit punues për INA në kuadër të MASH me qëllim të përgatitjes së raportit prej hulumtimit të realizuar elektronik me komunitet.
- **Publikimi i Doracakut për këshillat shkollorë për shkollat fillore dhe të mesme.** Doracakut për këshillat shkollorë për shkollat fillore dhe të mesme u publikua në ueb faqen e PINA në gjuhën maqedonase dhe shqipe (<http://pmio.mk/c2-capacity-building-materials/manual-for-school-boards-for-primary-and-secondary-schools/>).
- **Pjesëmarrje në tryezën e rumbullakët me temë “Aktivitete të MASH të cilat kontribuojnë për zhvillimin e multikulturalizmit, integritit ndëretnik dhe tolerancës”.** Ekipi i PINA-s mori pjesë në tryezën e rumbullakët “Aktivitete të MASH të cilat kontribuojnë për zhvillimin e multikulturalizmit, integritit ndëretnik dhe tolerancës”, në të cilën përfaqësues të institucioneve arsimore kyçe dhe të USAID-it diskutuan për rezultatet e hulumtimeve elektronike për INA në vitin 2016.
- **Realizimi i takimeve të mentorëve me EISH.** U mbajtën takime shitesë me 10 grupe të përfaqësuesve të shkollave të cilat nuk morën pjesë në ciklin e rregullt të takimeve të mentorëve, në periudhën tetor-nëntor 2016.
- **Përgatitja e dokumenteve ndihmëse për grante të financuara nga MASH.** Në procesin e mbështetjes së MASH lidhur me ndarjen e granteve për shkollat të cilat zbatojnë aktivitete të përbashkëta të nxënësve u përpunuan: udhëzime për grantistët për zbatimin e aktivitetit të përbashkët të suksesshëm dhe udhëzimi për promovimin e aktiviteteve dhe obligimeve të shkollës lidhur me grantin. Në vijim është përgatitja për punëtorinë për anëtarët e komisioneve për përzgjedhje e aplikacioneve për grant të MASH.

### Komponenti 3 – Shkolla modele

- **Orë të përbashkëta/të integruara.** Në dy shkolla fillore modele u mbajtën disa orë të përbashkëta të mësimit të rregullt me nxënësit e gjuhëve të ndryshme mësimore. Në SHF “Bratstvo Edinstvo”, komuna e Ohrit u mbajt një orë e integruar për gjuhën angleze si dhe një ditë e integruar (pesë orë të përbashkëta) me temë Viti i Ri. Në SHF “Sande Shterjoski”, komuna e Kërçovës u mbajtën dy orë të integruara të artit figurativ.
- **Punëtori multikulturore.** Në Shkollën fillore “Bratstvo Edinstvo”, komuna e Ohrit u mbajt punëtori tematike me rastin e Vitit të Ri me nxënësit dhe mësimdhënësit e të gjitha gjuhëve mësimore.
- **Shfaqje.** Me rastin e 21 Dhjetorit – Ditës së mësimit në gjuhën turke, në SHF “Bratstvo Edinstvo”, komuna e Ohrit u mbajt shfaqje me pika të përbashkëta të integruara si dhe me pika multikulturore.
- **Doracaku.** Doracakut për Pjesëmarrjen demokratike të nxënësve është shtypur në katër gjuhë mësimore.
- **Participimi demokratik.** Përmes bashkësisë shkollorë në shkollën e mesme ekonomike “Gostivari”, në komunën e Gostivarit janë përpunuar pano zbukuruese me mesazhe të Vitit të Ri. Në SHF “Sande Shterjoski”, komuna e Kërçovës bashkësia shkollorë në mënyrë aktive u përfshi në përpunimin e zbukurimeve të Vitit të Ri, si dhe shitjen e të njëjtave të Bazarin tregues të Vitit të Ri.
- **Piknikë.** SHF “Bratstvo Edinstvo”, komuna e Ohrit organizoi piknik me nxënësit e klasave të teta të të gjitha gjuhëve mësimore në Tetovë. Bashkërisht janë vizituar objekte të ndryshme të rëndësishme për të gjitha bashkësitë.



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



QENDRA  
MAQEDONASE PËR  
EDUKIM  
QYTETAR



## Projekt për integrimin ndëretnik në arsim

- **Promovimi i shkollave.** SHF “Bratstvo Edinstvo”, komuna e Ohrit pati dy shfaqje me të cilat mori formën e shkollës modele. Në një garë për Trash art të organizuar nga Pakomak, një ekip i shkollës i përbërë prej mësime dhe nxënësve të të gjitha gjuhëve mësimore e fituan çmimin e tretë për përpunimin më të mirë – fustan prej materialeve të ricikluara. Gjithashtu, në festën tradicionale për Vitin e Ri të organizuar nga komuna, shkolla u prezantua me pika të integruara (me nxënës dhe mësime të të gjitha gjuhëve mësimore).
- **Punëtori për ndryshime dhe efekte të arritura prej aktiviteteve INA.** U mbajtën katër punëtori me përfaqësues të EISH, mësime realizues të aktiviteteve por edhe mësime të cilët nuk janë përfshirë drejtpërdrejt në aktivitetet e projektit. Punëtoritë u mbajtën në shkollat modele “Bajram Shabani” dhe “Vëllezërit Milladinov”, komuna e Kumanovës, SHF “Sande Shterjoski”, komuna e Kërçovës si dhe në shkollën e mesme ekonomike “Gostivari”, komuna e Gostivarit. Në Takime janë prezantuar ndryshimet e arritura në shkollat modele, efektet e realizimit të aktiviteteve INA si dhe rezultatet e hulumtimit elektronik për INA në nivel të shtetit.

### Komponenti 4 - Nxitja e shkollave

- **Në vijim janë aktivitetet për rinovim** të cilat janë obligim i PINA në shkollën komunale fillore muzikore “Lazo Micev Rale”, komuna e Kavadarit.
- **Certifikata për pjesëmarrje në trajnime.** Janë përgatitur certifikata për pjesëmarrje në trajnimet për mirëmbajtjen e objekteve shkollore për anëtarët e EISH, sekretarët e shkollave dhe personelin teknik të 63 shkollave të rinovuara. Numri i përgjithshëm i certifikatave të shtypura, gjegjësisht të personave të cilët do të marrin certifikatë është 623.
- **Takime mujore në 15 shkolla të fazës 5 për ndjekjen e punës për mirëmbajtjen e objekteve shkollore.** Të gjitha 15 shkollat e rinovuara në fazën 5 janë kontaktuar nga persona profesionistë të cilët e ndjekin punën dhe procedurat për mirëmbajtjen e shkollave, me ç’rast u është ofruar ndihmë profesionale lidhur me mirëmbajtjen e objekteve shkollore (pozita ndërtimore, sistem për ngrohje, instalime elektrike, higjienë).

### Monitorimi dhe vlerësimi

- **Aktivitete për monitorim dhe vlerësim.** Monitorimi i aktiviteteve vijuese të PINA. Përpunimi i të dhënave nga vlerësimi i aktiviteteve të realizuara përmes grantit për përfshirjen e prindërve.
- **Hulumtimi elektronik.** Takim me grupin punues për INA në kuadër të MASH dhe prezantimi dhe diskutimi i rezultateve të hulumtimit elektronik me komunat.
- **Puna e raportit final për Monitorim dhe vlerësim.** Në vijim është përgatitja e raportit final për Monitorim dhe vlerësim.



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



QENDRA  
MAQEDONASE PËR  
EDUKIM  
QYTETAR



## Projekt për integrimin ndëretnik në arsim

### II. AKTIVITET VIJUESE PËR MUAJIN E ARDHSHËM

- **Komponenti 1 – Informimi i opinionit dhe bashkësive**
- Organizimi dhe mbajtja e trajnimit për mësuesit për udhëheqjen e këndeve kreative në kuadër të shkollave të tyre.
- Tryezë e rumbullakët “Roli dhe mbështetja e medieve në zhvillimin e kohezionit ndëretnik dhe integrimin në shkolla”.
- Mbajtja e punëtorive në kuadër të këndeve kreative me nxënësit dhe mësuesit.
- Azhurnim i rregullt i informacioneve dhe publikimi i risive dhe rrëfimeve gjatë aktiviteteve përmes faqes së Facebook-ut Integratika dhe ueb – faqes së projektit [www.pmio.mk](http://www.pmio.mk).
  
- **Komponenti 2 – Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorive të shkollave dhe arsimtarëve**
- Raport për rezultatet nga analiza e të dhënave të marra nga vlerësimi i pjesëmarrësve në aktivitetet me pjesëmarrjen e prindërve në INA.
- Përgatitja e modulit për punëtorin me përgjegjësit për arsim dhe koordinatorët EISH të 19 komunave për bashkëpunim të thelluar.
- Punëtorin me anëtarët e komisioneve për përzgjedhjen e grantistëve të MASH.
  
- **Komponenti 3 – Shkolla modele**
- Distribuimi i certifikatave për aktivitete INA.
- Mbajtja e prezantimeve shkollore për ndryshime dhe efekte prej aktiviteteve INA në dy Shkolla modele.
  
- **Komponenti 4 – Nxitja e shkollave**
- Aktivitete për rinovime dhe kontrollin teknik i objektit të rinovuar shkollor në SHFM “Lazo Micev Rale”, komuna e Kavadarit pas përfundimit të aktiviteteve ndërtimore.
- Takim me grupin e punës të komponentit 4.
- Takime mujore në 15 shkolla të fazës 5 për ndjekjen e punës për mirëmbajtjen e objekteve shkollore.
- Përgatitja e konferencës për prezantimin e praktikave të mira për mirëmbajtjen e shkollave për personelin teknik prej 63 shkollave të rinovuara.
  
- **Monitorimi dhe vlerësimi**
- Finalizimi dhe raporti final për Monitorim dhe vlerësim.
- Aktivitete me grupin punës për INA në kuadër të MASH.